

C.nr.1296/18

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm me gjyqtarin Burhan Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaji të cilën e përfaqëson [REDAKTUAR] Avokat nga Ferizaji, kundër të paditurës Komuna Ferizaj - Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson [REDAKTUAR] për çështjen kontestuese pagesa e pagave përcjellëse dhe shpërblimit jubilar, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 19.02.2019, merr këtë:

### AKT GJYKIM

**I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditëses [REDAKTUAR] nga Ferizaji, e ushtruar kundër të paditures Komuna Ferizaj - Drejtoria e Arsimit, si e bazuar.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna Ferizaj - Drejtoria e Arsimit, që paditëses, në emër të tri pagave përcjellëse të ia paguaj shumën prej 889.41€ si dhe në emër të shpërblimit jubilar, t'ia paguaj shumën prej 889.41€ në shumë të përgjithshme prej **1,778.82 €** (njëmijë e shtatëqind e shtatëdhjet e tetë euro e tetëdhjet e e dy cent) me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 259.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### Arsyetim

Paditësja me datë 27.12.2018, ka parashtruar padi kundër të paditures, lidhur me pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë duke theksuar se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën deri në arritjen e moshës së pensionimit më dt 10.02.2017 dhe se nuk ka realizuar të drejtën në kompensim të pagava përcjellëse e as të pagave jubilarë ashtu siq parashikohet me kontratën kolektive.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të ushtruar pranë kësaj gjykate, duke deklaruar se tek e paditura deri në moshën e pensionimit pra deri më datën 10.02.2017 dhe se ka prevojën e punës rreth 43 viteve duke precizuar kërkesën dhe kërkuar shumën prej 889.41€uro në emër të tri pagave përcjellëse dhe shumën e njejtë për tri paga jubilarë sepse një gjë e tillë i takon paditëses,

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar duke përfshirë shpenzimet për përpilim të padisë shumën 104 euro, për përfaqësim në një seancë shumën 135 euro dhe për taksën gjyqësore shumë prej 20 euro.

mbështetur pretendimin e saj në këtë pikë kontestuese, andaj gjykata me rastin e vendosjes të lartësisë së kërkesëpadisë, është bazuar në provat materiale të cilat i ka ofruar paditësi, siç janë: pasqyra e llogarisë bankare në emër të paditësit dhe lista e pagave e lëshuar nga e paditura kurse realizimi i paditëses për muajin e fundit të pagës prej 140.45€ gjykata e ka vlerësuar si pagë e përgjysmuar për shkak të arritjes së moshë së pensionit në mes të muajit, ndërsa kontrata kolektive precizon të drejtën në tri paga që ka kuptimin e pagave të plota në tre muajt e fundit, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e lartë cekura, konform nenit 143 dhe 319 të LPK-së, lidhur me nenin 36 pika 9 dhe 10 të Kontratës Kolektive me nr.21 dt. 11.04.2014 për Arsimin Parauniversitar e nënshkruan në mes të SBASHK-ut dhe MASHT-it, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata ka vendosur konform nenin 452.1 të LPK-së, me çka e ka detyruar të paditoren që paditësit t'ia paguan shpenzimet e procedurës në shumë prej 259.00 € dhe atë si në vijim: për përpilim të padisë shumë 104.00 €, për përfaqësim në një seancë shumë 135.00 € dhe për taksën gjyqësore shumë 20.00 €.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**  
**C.nr.1296/18 datë 19.02.2019**

Gjyqtari,

**Burhan Berisha**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUNDËSHMËR  
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më  
Dana

15 02 2019

